

Turcin 2752

Tetovo

Skopje

HARTA E LOKALITETEVE NË RAJONIN E MALIT TË ILINËS



Liqeni i Oslloresë

Llopushnik

Ujvarata e Zanave,
fshati Dobrenoec Kërçovë

Shtëpia e Arteve
Knezhinë

Manastiri i Knezhinës
Shën Georgij Podedonosec
(Shn. Gjergji)

Kalaja e Qytetit

Fshati Ehloec, Kërçovë

Burimi i Lumit Treska

Manastir Shën
Bogorodica Preçista

Burimi i ujit mineral,
fshati Svinjishte

Kërçovë

Mali i Ilinës

HARTA E LOKALITETEVE DHE MUNDËSI PËR BIZNES NË RAJONIN E KËRÇOVË DHE NË RAJONIN E MALIT TË ILLINËS



Manastiri i Shn. Bogorodica – Preçista

Manastiri i Shn. Bogorodica – Preçista është i njohur si Manastiri i Kërçovës ose Manastiri i Krinës, një manastir mesjetar në zonën e qytetit të Kërçovës. Është i vendosur në malin e Cocës, në lartësi mbideatore 920 metra. Deri te ky manastir mund të arrini kur të largoheni nga Kërçova dhe të shkoni përgjatë rrugës magjistrale për Manastir, 10 km në jug të qytetit. Ai në fakt është tempul i shenjtë i të gjithë besimtarëve, pa dallim a janë ose sjanë odrtodoks. Mbrendësia e kishës ashtu është e bërë, që nën një çati të mbliiden edhe të krishterët dhe muslimanët, të cilët e repsektojnë njëlloj.



Manastiri i Knezhinës Shn. Georgin Pobedonosec (Shn. Gjergji)

Manastiri i Knezhinës – kompleks manastiresh në rajonin e Kopaçkës, në perëndim të qyteit të Kërçovës, në afërsi të fshatit Knezhinë. Manastiri gjenden në shpatet e malit Bistra, në lartësi mbidetare 900 metra. Zona është e pasur me bimësi me pyll ahu dhe dushku. Në oborrin e manastirit aty janë dy burime nëpër të clat rrjedh ujë burimi, që populli e konsideron si shërues.

Kalaja e qytetit



Kalaja e qytetit – lokaliteti arkeologjik në Kërçovë të tipit të vendabinit të fortifikuar nga epoka e bronzit dhe hekurit, si dhe mesjetës. Vendi e ka marrë emrin Kitino Kale nga princesha Kita, motra e mbretit Marko, e cila ka jetuar në pallatin e Kalasë. Kërçovën në atë kohë e kan quajtur edhe Kitingrad. Kalaja mbulon një sipërfaqe prej 1.5 hektarësh dhe përfshin mure prej 440 metra të gjatë dhe pesë kulla. Pranë mureve kishte edhe një kullë ore, e cila është shkatërruar nga një zjarr.

Shtëpia e arteve – fshati Knezhinë



Një vend i përsour për pushim dhe relaksim, një vend i veçantë për tu vizituar çdo ditë gjatë gjithë vitit. Vetëm 6 kilometra larg qytetit të Kërçovës, Shtëpia e Arteve gjendet në 960 metra lartësi mbidetare e rrethuar me pyll të dendur me pisha dhe dushqe dallohet nga fakti se vite më parë ishte mikëpritis dhe një nga organizatorët e një kolonie ndërkombërate arti.

Burimi i lumit Treska



Burimet e Lumit Treska janë lumi Eloveçka në anën lindore të malit Stogovo dhe lumit Beliçka nga shpatata veriore të malit të Ilinës. Rrjedhja e lumit Treska fillon në fshatin Drugovë, Kërçovë ku dhe bashkohen këto dy lumenjë. Përgjatë rrjedhës së saj në rajonin e Kërçovës, lumi quhet lum i madh, dhe në pjesën e porës Velika Reka (lumi i madh). Prnaë burimit të lumit Treska ndohet fshati Izvor.

Fshati Ehloec, Kërçovë



Fshati gjendet në rrethinën e Kopaçka, në pjesën jugore të teritorit të komunës së Kërçovës, atari i të cilit prek gjerësisht zonën e komunës së Mavrovës dhe Rostushës fshati është malor, në lartësi mbidetare 1040 metra. Nga qyteti i Kërçovës është larg 19 km. Është fshati më i largët nga lugina e Kërçovës, ndodhet në pjesën jugperëndimore të saj. Gjendet në burimet e lumit Treska në shpatet e malit Stogovo. Ehloec është i njohur si një fshat unik (mijaço) në anën lindore të vargamlit malor Bistra – Stogovo që natyrshëm graviton drejt Kërçovës. Në atarin e këtij fshati ndodhet edhe lokaliteti i biznesit “Kuqare na planin” (shtëpi në mal).

Liçeni i Oslomesë



Liçeni i Oslomesë- liçen artificaila në afërsi të fshatit Strellcë dhe Shutovë, në rajonin e Kërçovës. Liçeni hyn në grupin e akumulimit e formuara dhe ndodhi në një nga gorpat e minierës së qymyrit të TEC “Oslomej”. Liçeni ka sipërfaqe në mbi 30.000 metër katror dhe ka maksimum thellësi prej 15 metrash. Liçeni vazhdimisht pajiset me peshqi dhe është i përshtatshëm për zhvillimin e turizmit të peshkimit dhe rekreacionit.

Burimet e ujit mineral, fshati Svinjishta



Fshati Svinjishta Kërçovë është i vogël, por me bukuri natyrore të mëdhaja ku ka burim të pa shtershëm me ujë mineral. Vazhdimisht rrjedh nga dy çezme, kurse buron nga burimet malore. Uji konsiderohet se është shërues, në fshat vinë vizitorë nga të gjitha anët e tokës vetëm të mbushin ujë. Ky fshat përveç se është i njofshëm i famshëm për burimet e ujit mineral, është i njofshëm edhe për bluarjen e miellit në mullirin e fshatit e cila gjendet në afërsi të burimeve me ujë mineral, dhe u rinovua nga një iniciativë qytetare e grupit lokal Treska.

Mali i Ilinës



Mali i Ilinës ose një mal i gjerë është një mal mesatar i lartë në perëndim të Maqedonisë me drejtimin dinar që shtrihet nga veriperëndimi në juglindje. Majat më të larta janë Liska (1.909 m) dhe Starec (1.577 m). Në malin e Ilinës janë zhvilluar burimet e lumenjve Mramore dhe Beliçka. Faqet e malit janë nën pyll, dhe pjesët më të larta nën kullota. Ka bollëk me pyll ahu në pjesët e larta dhe të mesme si dhe dushku në pjesët e poshtme. Pikërisht për shkak të mundësive që ofron, është gjithnjë e më tepër i dëshiruar si destinacion turistik për turizmin malor ecje dhe rekreacion.

Ujvarrat e Zanave, fshati Dobrenoec, Kërçovë



Ujvarrat e Zanave – ujvarre të cilët gjenden në rrjedhën e lumit Studençica, në veriperëndim të fshatit të braktisur Frlogoec. Janë rreth 15 km larg Kërçovës në lartësi mbidetare 1250 metra. Mbushen me ujë nga burimet që vijnë nga Zhenska mali dhe Pashinica (pjesë të Bistrës). Të dy ujvarret e Zanave janë konstante gjatë gjithë vitit, me një rënie uji prej 15 metrash (i vogël) kurse i madhi 25 metra (i madh). Deri te ato mund të arrihet nga një rrugë e shënuar në gjatësi prej 3.5 km e cila fillon nga ujëmbledhësi i lumit Studençica, në të cilën të çon një rrugë dheut nga fshati Dobrenoec i Epërm.

Llopushnik



Llopushnik është mal i cili është dega jugore e malit Bistra. E gjithë zona është më e ulët se majat e Bistrës përreth dhe është me një pyll të dendur ahu. Pika më e lartë është maja e Stog me lartësi mbidetare prej 1,574 metra. Në historinë e Maqedonisë mali është i famshëm për atë se në këto shpate në NOB për një kohë të caktuar ka ndejtur selia kryesore e NOB. Në radhët e partizanëve të Llopushnikut ka qenë edhe Koço Racin, poeti i njohur maqedonas dhe revolucioner, i cili e shkruajti koleksionin “Beli Lugri” dhe ku aty ka humbur jetën. Përkujtimorja gjendet në 1.500 metra në lartësi mbidetare dhe çdo vit tradicionalisht përkujtohet përvjetori i vdekjes së tij.